

Bashkohuni në një Ngjarje për Pranimet në Shkollë të Mesme!

Të nderuara familje,

Jemi të entuziazmuar t'ju ftojmë të merrni pjesë në një nga sesionet tona virtuale informuese mbi pranimet në shkollat e mesme në Nju Jork! Të gjitha familjet e NYC me nxënës të klasës së tetë inkurajohen të marrin pjesë. Procesi i pranimit në shkollë të mesme do të hapet të **martën, 7 tetor 2025**.

Gjatë këtyre sesioneve, do të flasim për mënyrën si të eksploroni shkollat dhe programet, si të ndërtoni një aplikim të balancuar, si të regjistroheni për Specialized High School Admissions Test (Testi i Pranimeve në Shkollat e Mesme të Specializuara – SHSAT), si të bëni audicion për programet e arteve dhe si bëhen ofertat. Pas çdo prezantimi, do t'u përgjigjemi pyetjeve tuaja.

DATAT E PLANIFIKUARA:

- **E mërkurë, 8 tetor, 17:00–18:00 | Ngjarje e Përgjithshme për Pranimet në Shkollë të Mesme:** Përmbledhje e procesit të pranimit, nga mënyra si të hyni në llogarinë tuaj MySchools deri te strategjitë më të mira për plotësimin e aplikimit. Ngjarja zhvillohet në anglisht dhe ofrohet përkthim në: Bangla, Kinezçe (Mandarin), Rusisht, Spanjisht dhe Gjuha me Shenja Amerikane (American Sign Language - ASL).
- **E enjte, 9 tetor, 17:00–18:00 | Shkollat e Mesme të Specializuara me Testim:** Si të regjistroheni për SHSAT, si të përgatiteni për SHSAT-in digjital dhe si bëhen ofertat për këto shkolla. Ngjarja zhvillohet në anglisht dhe ofrohet përkthim në: Arabisht, Bangla, Rusisht, Spanjisht dhe ASL.
- **E martë, 14 tetor 2025, 18:00–19:00 | Ngjarje e Përgjithshme për Pranimet në Shkollë të Mesme.** Ngjarja zhvillohet në anglisht dhe ofrohet përkthim në: Shqip, Arabisht, Kreole Haitiane, Urdu dhe Gjuha me Shenja Amerikane (American Sign Language - ASL).
- **E mërkurë, 15 tetor 2025, 17:00–18:00 | Ngjarje e Përgjithshme për Pranimet në Shkollë të Mesme për Nxënësit me Aftësi të Kufizuara.** Ngjarja zhvillohet në anglisht dhe ofrohet përkthim në: Bangla, Kinezçe (Mandarin), Rusisht, Spanjisht dhe Gjuha me Shenja Amerikane (American Sign Language - ASL).
- **E enjte, 16 tetor, 17:00–18:00 | Ngjarje e Përgjithshme për Pranimet në Shkollë të Mesme në Spanjisht.**
- **E enjte, 23 tetor, 17:00–18:00 | Ngjarje e Përgjithshme për Pranimet në Shkollë të Mesme në Kinezçe (Mandarin).**



- **E premte, 24 tetor, 15:00–16:00 | Ngjarje e Përgjithshme për Pranimet në Shkollë të Mesme.** Ngjarje në Anglisht. Përkthimi do të ofrohet në Koreanisht, Rusisht, Spanjisht dhe Uzbekisht.
- **E enjte, 30 tetor, 18:00–19:00 | Shkollat e Mesme të Specializuara me Testim.** Ngjarje e mbajtur në Anglisht. Përkthimi i disponueshëm në: Kinezçe (Mandarin), Frëngjisht, Koreanisht, Urdu dhe ASL.

SI TË MERRNI PJESË NË ÇDO NGJARJE:

- Secili takim do të zhvillohet drejtpërdrejt live. Bashkohuni në Zoom në orën e fillimit të ngjarjes duke klikuar këtu <https://bit.ly2025FallHSEvents>
- ID Uebinarit: 990 1261 6744
Fjalëkalimi: 123456 ose
- Për audio në telefon:
US+ 16469313860
Përmes telefonit: 99012616744#
Fjalëkalimi 123456#

SHËNIM I RËNDËSISHËM: vizitoni schools.nyc.gov/HS ku do të gjeni numrat e telefonit për të telefonuar për interpretim në secilën gjuhë.

Presim me padurim t'ju kemi në ngjarjet tona dhe ju inkurajojmë të qëndroni të lidhur, schools.nyc.gov/HS.

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi të dërgoni email në HSEnrollment@schools.nyc.gov.

Gjithë te mirat,

Ekipi i pranimeve në shkollat e mesme të larta
Office of Student Enrollment (Zyra e Regjistrimit të Nxënësve)



Ju është përcjellë ky email nga një mik? Sigurohuni të regjistroheni në listën tonë të postimeve për pranimet në shkollë të mesme dhe/ose të mesme të ulët te schools.nyc.gov/SignUp.

Nëse dëshironi të çregjistroheni nga mesazhet e ardhshme rreth pranimeve në shkollë të mesme dhe/ose të mesme të ulët, ju lutemi klikoni [këtu](#).